

VENDIM
Nr. 87, datë 31.1.2020

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË TË
KRYEJË PROCEDURAT E PROKURIMIT, NË EMËR TË QENDRAVE TË
TRAJTIMIT TË STUDENTËVE NË QYTETET SHKODËR, VLORË DHE KORÇË,
PËR KOMPLETIMIN E AMBIENTEVE TË BRENDSHME TË GODINAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të qendrave të trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë, për kompletimin e ambienteve të brendshme të godinave me mobilje dhe pajisje të tjera akomoduese e ndihmëse, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2020.

2. Procedurat ligjore dhe fondet përkatëse për realizimin e kontratës publike të furnizimit për kompletimin e ambienteve të brendshme të godinave të qendrave të trajtimit të studentëve në qytetet sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të kryhen dhe do të sigurohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme”, programi buxhetor 09450, “Arsimi i lartë”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

3. Përfituesit do të jenë qendrat e trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë, të cilat do të kryejnë procedurat për marrjen në dorëzim dhe inventarizimin e pajisjeve të furnizuara e të vendosura apo të instaluar, në përputhje me sasitë dhe çmimet e përcaktuara në kontratën publike të furnizimit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe qendrat e trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRËR
Edi Rama